



*RAPORT I PUNËS SË  
ODËS E FARMACISTËVE TË KOSOVËS  
Qershor 2018 – 21 Qershor 2019*

*(Prishtinë, Qershor 2019 )*

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| <b>HYRJE</b> .....  | 5  |
| <b>1. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË OFK-së</b> .....   | 6  |
| <b>1.1 Zgjedhja e oraganeve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës të OFK-së</b> ..... | 6  |
| <b>1.2 Zgjedhja e Prokuroit të Odës, Gjyqit të Nderit dhe Këshillit Etik</b> .....            | 7  |
| <b>1.2.1 Zgjedhja e Komisioneve të Përhershme</b> .....                                       | 7  |
| <b>1.2.2 Zgjedhja e Komisioneve të Përkohëshme</b> .....                                      | 8  |
| <b>2. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI</b> .....  | 9  |
| <b>3. EDUKIMI I VAZHUESHËM PROFESIONAL</b> .....  | 10 |
| <b>4. ÇËSHTJET ETIKE</b> .....  | 12 |
| <b>5. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE</b> .....   | 13 |
| <b>6. SONDAZHET DHE HULUMTIMET</b> .....  | 13 |
| <b>7. NDËRKOMBETARIZIMI I OFK-SË</b> .....  | 14 |
| <b>7.1 International Pharmaceutical Federation (FIP)</b> .....                                | 14 |
| <b>7.2 Pharmaceutical Group of European Union- PGEU</b> .....                                 | 15 |
| <b>7.3 Asociacioni i Odave të Evropës Juglindore</b> .....                                    | 15 |
| <b>8. BASHKPUNIMI ME INSTUCIONE TJERA DHE LOBIMET</b> .....                                   | 15 |
| <b>8.1 Inspektoriati farmaceutik</b> .....  | 15 |
| <b>8.2. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale</b> .....                       | 16 |
| <b>8.3 Fushata "Per barna - fol me farmacistin"</b> .....                                     | 17 |
| <b>8.4. Komiteti Specialistik</b> .....   | 19 |
| <b>8.5 Konferenca vjetore e farmacisë</b> .....   | 20 |
| <b>8.6 Diskutimi publik me farmacistë dhe insitucionet publike</b> .....                      | 20 |

8.7 Ligji për paga..... 21

8.8 Projekti lidhur me implementimin e skemës së barnave jashtëspitalore me komponentat përcjellëse të kontraktimit dhe reimbursimit të barnave .....22

8.9 Takimi me Komisionin për Shëndetësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës .....23

8.10 Bashkpunimi me degën e farmacisë të Universiteti “Hasan Prishtina” .....23

8.11. Koncept dokumenti për ndryshimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale .....24

8.12 Udhëzimi administrativ për shkollim specialistik dhe bordi qendrorë për shkollim specialistik .24

8.13. Grupi punues për të drejtat dhe përgjegjësitë e profesionistëve shëndetësorë.....25

8.14 Udhëzimi administrati për unifikimin e cmimit të barnave.....25

8.15 Objekti i përbashkët i Odave të Profesionistëve Shëndetësorë.....26

8.16 Digjitalizimi i shërbimeve .....26

9 TAKIME TJERA TË NDRYSHME GJATË VITIT TË PARË .....27

9.1. Takimi me ShSKUK.....27

9.2 Takimi me delegacionin nga Global Health Policy Research Lab të Dartmouth Nelson A. Rockefeller Center for Public Policy, SHBA .....27

9.3. Takimi i organizuar nga KDI .....28

9.4 Takimi për amendamentimin e Ligjit për Narkotik.....28

9.5. Vizita te prodhuesit vendorë Trepfarm dhe Gentipharm .....29

9.6 Konferenca e 3 të nderkombetare e shkencave mjeksore e organizuar nga Universiteti I Tetoves .29

9.7 Dita ndërkombëtare e mbulimit universal me shërbime shëndetësore .....30

9.8 Takimi në Gjenevë në selinë e OBSH dhe në Kopenhagë në zyrat e OBSH - Euro..... 31

9.9 Takimi me Rrjetin e Konsumit të Antimikrobikëve (Antimicrobial Consumption Netëork) në OBSH Euro në Kopenhagë..... 31

9.10 Debati për Cmime i organizuar nga Ministria e Shëndetësisë..... 32

9.11 Në takimin me AKPPM dhe Inspektorati për Udhëzimin e ri Administrativ për kushtet e licencimit të Depove të barnave ..... 33

9.13. Kongresi i 6-të i farmacisë në Dubrovnik..... 34

9.14. Takimi për listën e barnave esenciale me komitetin profesional..... 34

|   |           |
|---|-----------|
| <b>9.15. Dita Botërore e Shëndetit.....</b>   | <b>35</b> |
| <b>9.16 Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë .....</b>  | <b>35</b> |
| <b>9.17. Takimi me Minsitrin e Shëndetësisë dhe zyrtarët nga Autoriteti i konkurrencës.....</b> | <b>35</b> |
| <b>10. RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHEN 01.01.2018-31.12.2018 .....</b>                          | <b>36</b> |
| <b>11. AKTIVITET 2019 .....</b>   | <b>39</b> |
| <b>11.1 Plani Financiar 2019 .....</b>  | <b>40</b> |

## HYRJE

---

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Ky raport paraqet një pasqyrim të punës dhe aktiviteteve të organeve të OFK-së për periudhën raportuese Qershorë 2018 – Qershorë 2019 i cili konsiston nga dita kur Kryetari i zgjedhur nga përbërja e dytë e Kuvendit të OFK-së ka pranuar detyrën si Kryetar i OFK-së.



**Arianit Jakupi**  
**Kryesues i KD**

E veçanta e këtij raporti është se përmbajtja e tij është përmbledhur dhe shtypur në formë të publikimit-brosurës dhe në brendësi përmban një përshkrim të aktiviteteve dhe shërbimeve të OFK-së gjatë periudhës raportuese

Ky raport ka 43 faqe dhe është i ndarë në 11 kapituj, në të cilat pasqyrohen më shumë se 40 aktivitete nga organet e OFK-së të ndërrmara gjatë vitit të parë të mandatit të organeve.

Aktivitetet e paraqitura në raport janë ilustruar me nga një apo më shumë foto representative, dhe të dhënat e ofruar janë paraqitur në diagrame.

Ky format dhe model i raportimit do të shërbej si standard i raporteve vjetore të OFK-së, në mënyrë që të mundësohet një qasje më e lehtë e krahasimit dhe evaluimit të shërbimeve dhe aktiviteteve të OFK-së prej viti në vit.

Raportet vjetore të punës së OFK-së do të publikohen në web- faqen e Odës së Farmacistëve të Kosovës, pasi të miratohen nga Kuvendi i OFK-së.

Falenderojmë të gjitha anëtarët e organeve të OFK-së të cilë kanë kontribuar drejt rrugimit dhe sukseseve të përshkruara brenda raportit.

## 1. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË OFK-së

### 1.1 Zgjedhja e organeve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës të OFK-së

Më 9 korrik 2018 u mbajt Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës në të cilën u bë zgjedhja e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikqyrës

Kandidatë **Shkumbin Jusufi, Sabrije Fazliu-Asllani, Agon Hoti, Florina Berisha dhe Nazif Qazimi** u zgjedhën anëtarë të Këshillit Drejtues të OFK

Në Këshillin Mbikqyrës u zgjedhën: Bekim Ahmeti – Kryetar, Driton Gashi – Nënkyetar, Drita Selimi – Anëtare, Besnik Gjickolli – Anëtar, Fidan Reçica - Anëtar

Për zv. Kryetar të Odës së Farmacistëve të Kosovës u zgjedhën znj.Dardane Mehaj dhe z. Gjon Gega`



## 1.2 Zgjedhja e Prokuroit të Odës, Gjyqit të Nderit dhe Këshillit Etik

---

Me datë 08.09.2018 është mbajtur Kuvendi i Odës së Farmacistëve në të cilën janë bërë zgjedhja e Prokuroit të Odës, Gjyqit të Nderit, Këshillit Etik dhe Komisioneve të OFK-së dhe u vendos për ndarjen e mirnjohjeve të gjithë përbërjes së parë të Kuvendit të OFK-së, anëtarave të KQZ-së dhe gjithë personave që kanë ndihuar në funksionalizimin dhe ngritjen e OFK-së.

Për Prokurorë të Odës nga Kuvendi u zgjodh z. Driton Shabani - Prokuror dhe z. Nazif Qazimi zv.Prokuror.

Në Këshillin Etik u zgjodhen Ilir Luzha - kryetarë, Gzonit Salihaj - zv.kryetar, Shpëtim Fazliu-anëtar, Edin Dalo-anëtar.

Në Gjyqin e Nderit u zgjodhën Demush Bajraktari - Kryetar, Jeton Gutaj - zv.kryetar, Shkëlzen Dërguti - anëtar, Blerina Ahmetxhekaj - Anëtare dhe Muhamet Sallova - Anëtar.

### 1.2.1 Zgjedhja e Komisioneve të Përhershme

---

Në takimin e Kuvendit të datës 08.09.2018 u zgjodhën edhe anëtarët e Komisioneve të Përhershme.

- Në komisionin për edukim të vazhdueshëm profesional u zgjodhen: Demush Bajraktari - Kryetar, Fjolla Kullashi - Spahija - zv.kryetare, Nora Rrahimi Hasani - anëtare, Fidan Reçica - Anëtar dhe Jeton Gutaj – Anëtar.
- Në komisioni për licencim: Astrit Haxhijaha - Kryetar, Ariana Prenaj zv.kryetare, Astrit Iljazi - anëtar, Anita Muli-anëtar dhe Menotr Sylja- anëtar.
- Në komisioni për buxhet dhe financa: Agon Hoti - Kryetar, Selveta Shuleta-zv.kryetare, Floriana Latifi - anëtare, Arsim Haliti-anëtar dhe Besnik Gjokolli – Anëtar.
- Në komisionin për edukim Specialistik: Visar Emini - Kryetar, Agon Shala-zv.kryetar, Shkëlzen Dërguti -anëtar, Driton Shabani - anëtar dhe Besa Asllani – anëtare.

- Në komisionin për çështje etike: Betim Ramadani-Kryetar, Teuta Balidemaj - zv.kryetare, Alban Bakolli- anëtar, Artan Maliqi - anëtar dhe Seniha Salah- anëtare.
- Në komisionin për solidaritet dhe ndihmë reciproke: Milaim Abdullahu - Kryetar, Edona Hasani - zv.kryetare, Linda Avdyli- anëtare, Armend Lamaxhema -Anëtar dhe Fatbardha Murtezi - Anëtar.
- Në komisionin për praktiken private profesionale: Liridon Shala - Kryetar, Fatlinda Drejta - Karahoda-anëtare, Drin Vula-anëtar, Kaltrina Smajli Vokshi - anëtare dhe Valon Ejupi - anëtar.
- Në komisionin për Mardhënie Ndërkombëtare : Gjon Gega - Kryetar, Lutfi Mulaku - zv.kryetar, Bekim Ahmeti - anëtar, Eda Mehmeti - anëtare dhe Ardian Rugova – anëtar.

### 1.2.2 Zgjedhja e Komisioneve të Përkohëshme

Në takimin e Kuvendit të datës 08.09.2018 u zgjodhen edhe anëtarët e Komisioneve të Përkohëshme:

- Në komisionin për farmaci komunitare : Shkumbin Jusufi - Kryetar, Visar Ademi - zv.kryetar, Alban Desku - anëtar, Besim Azemi - anëtar dhe Asllan Axhanela -anëtar.
- Në komisionin për farmaci spitalore: Lirim Mustafa - Kryetar, Erblin Elezi - zv.kryetar, Labinot Pira - anëtar, Shpend Dragusha - anëtar dhe Shpëtim Fazliu - Anëtar.




## 2. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI

Gjatë periudhës 20 Shtator 2018 - 22 Qershor 2019, Komisioni për licencim ka vazhduar me procesin e anëtarimit licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve shëndetësor.

Për herë të parë me qëllim të rritjes së transparencës është publikuar regjistri i Licencave të Farmacistëve i cili është i qasshëm në web faqen e OFK-së në të cilin pasqyrohen se kur është lëshuar një licencë dhe datën e skadimit të saj. Ky regjistër përditësohet në baza mujore.

Në këtë periudhë Komisioni për Licencim ka anëtarësuar 106 farmacistë, ka licencuar 103 farmacistë dhe ka rilicencuar 61 farmacistë.



Komisioni për licencim me të marrë mandatin ka filluar hartimin e rregulloreve me të cilat janë rregulluar afatet dhe procedurat për anëtarësim, licencim dhe rilicencimin e farmacistëve të cilat i ka dërguar për miratim në Këshillin Drejtues. Këtyre rregulloreve i janë bashkangjitur edhe formularët përkatës të rregulloreve.

### 3. EDUKIMI I VAZHUESHËM PROFESIONAL

Gjatë periudhës 13 Shtator 2018 - 22 Qershor 2019, Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional ka vazhduar ushtrimin e kompetencave të tijë të përcaktuara nga legjislacioni aktual.


Brenda periudhës raportuese komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional ka draftuar rregulloren për edukim të vazhdueshëm profesional në të cilën janë rregulluar procedura për akreditimin e aktiviteteve, aftësimi profesional dhe përkrahja për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së. Kësaj rregullore KEVP i ka bashkangjitur edhe të gjithë formularët e paraparë në rregullore.

KEVP gjatë periudhës raportuese ka akredituar 11 aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional.

- 1) **“Kongresi i parë i Biokimistëve të Kosovës”** – SHBKK (Nr.130, datë: 28.09.2018)
- 2) **Kongresi “Profesionisti shëndetësor, Pacienti dhe te Drejtat e tyre”** – PRAK (NR.129, datë 28.09.2018)
- 3) **Kursi “Përdorimi dhe efektet e produkteve natyrore të infeksionet vaginale”** – Rivita, Exclusive (Nr. 132, datë05/10/2018)
- 4) **Konferenca “International UBT Conference on Medical, Dental and Pharmaceutical Science”** – Kolegji UBT (Nr. 142, datë: 22/10/2018)
- 5) **Konferenca Vjetore e Farmacisë “Sigurimet Shëndetësore dhe roli i farmacistit në këtë proces”** – OFK (Nr. 147, datë: 14.11.2018)
- 6) **Kursi “Punëtorja treditore nga Inspektorati Farmaceutik”** – IF (Nr. 148, datë 21.11.2018)
- 7) **“Ndikimi i preparative bimore te shëndeti i njeriut”** – (Nr.05/06/02/2019)
- 8) **“Terapitë integrative në mjediset e praktikës farmaceutike”**, i organizuar nga Medico Marketing Associated sh.p.k. (Nr. 06, datë: 06/02/2019)
- 9) Konferencën **“Zhvillimet aktuale në shkencën dhe profesionin farmaceutik”**, i organizuar nga Shoqata e Farmacisteve në bashkëpunim me degën e Farmacisë të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (Nr. 16e-1, datë: 17/04/2019)
- 10) **“Shëndeti dhe përparësitë e përdorimit të shtesave ushqimore te njeriu”** - Gala Line shpk (Nr.14e-1, datë: 29.05.2019)

11) "Transformimi dhe kujdesi farmaceutik " - Oda e Farmacistëve të Kosovës (nr. 23e-1, datë 17.06.2019)

Në periudhen raportuese KEVP ka lëshuar 9 vërtetime mbi valorizimin e pikëve kredituese të anëtarësve të saj si dëshmi se plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre.



#### 4. ÇËSHJET ETIKE

Organet nën kompetencën e të cilave bien çështjet etike kanë filluar mandatin nga shtatori 2018. Pas pranimit të detyrës, Këshilli Etik së bashku me Gjyqin e nderit, Prokurorin e Odës kanë filluar hartimin e rregullores unike me të cilën do të përcaktohet shkalljet etike, klasifikimin e masave disiplinore që do të shqiptohen me rastin e shkeljeve etike, dhe gjithë procedurën që do të ndjeket me rastin e shqiptimit të masave disiplinore. Synimi i hartimit të kësaj rregullative është që anëtarëve të saj ti ofrojë një rregullore unike për sa i përket çështjeve etike me qëllim të shmangies së çfarado konfuzioni të anëtarëve rreth procedurave etike.

Kjo rregullore është në fazën finale të hartimit, por që për shkak të volumit të madh dhe rëndësisë së posaçme që ka për funksionimin e OFK-së dhe komunitetin farmaceutik në përgjithësi është lënë që aprovimi i saj të ndodhë në Kuvendin e radhës, për shkak të implikimeve dhe rolit shtesë që ka dhënë Ministria e Shëndetësisë me Udhëzimin Administrativ nr 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale i cili i siguron OFK-së rol kyç Odës së Farmacistëve të Kosovës në procesin e mbikqyrjes së zbatueshmërisë të këtij Udhëzimi Administrativ.

Në periudhën raportuese, janë shqyrtuar 2 raste për shkelje etike, prej të cilave njëri është refuzuar për shkak të parashkrimit të lëndës etike, dhe në rastin tjetër është shqiptuar masa disiplinore e qortimit publik pasi edhe vetë pala e kishte pranuar shkeljen (vendimi nr 05 i datës 15/02/2019). Vendimi për shqiptimin e kësaj mase është i formës së prerë pasi pala nuk ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të këshillit etik.

Komisioni etik ka filluar draftin e rregullores me të cilin do të përcaktohet fushëveprimi i komisionit, me që nga përbërja e I-rë e Kuvendit nuk ka, akt të miratuar me të cilin do të rregullohej fushëveprimi i këtij komisioni

## 5. SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

---

Në komisionin për solidaritet dhe ndihme reciproke gjatë periudhës raportuese janë paraqitur 2 raste. Një rast është kërkuar ndihmë financiare nga kolegët për mbulimin e shpenzimeve të spitalit për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të një anëtari të OFK, dhe një rast ka kërkuar lirim nga taksa administrative e anëtarësisë për shkak të pamundësisë ekonomike-financiare për pagesën e sajë.

Në rastin e parë Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke ka shqyrtuar dokumentacionin e anëtarit të OFK-së dhe ka propozuar Këshillit Drejtues ndarjen e shumës prej 1,000€ ndihmë anëtarit.

Po ashtu, komisioni ka vendosur lirim nga taksa administrative e anëtarësisë për kërkesen tjetër.

## 6. SONDAZHET DHE HULUMTIMET

---

Gjatë mbajtjes së konferencës **“Sigurimet Shëndetësore dhe roli i farmacistit në këtë proces”**, Komisioni për Barnatore Komunitare i OFK-së ka realizuar një anketë me 311 të pranishëm në konferencë.

Qëllimi i këtij pyetsori ka qenë identifikimi i probleme kryesore me të cilat përballet sot komuniteti farmaceutik (barnatoret komunitare, që e përfshijnë pjesën dërmuese të këtij sektori, në Kosovë.

Nga 311 pyetsorë të plotësuar nga pjesmarrësit aktiv të konferencës, janë përpunuar të gjitha rezultatet, por në vazhdim po i komentojmë vetëm disa shqetësime më të mëdhaja të komunitetit:

1. Për pyetjen e cila ka të bëjë me cmimet e barnave, 95% e përgjigjeve kanë dalë për përcaktim të cmimit në banderolë (unifikim të cmimit të barit)
2. 89% e pjesmarrësve kanë deklaruar se duhet të ketë distancë të caktuar ndërmjet dy barnatoreve.
3. Rreth 85% e pjesmarrësve janë përgjigjur se pronar i barnatores komunitare duhet të jetë vetëm farmacisti.
4. 81% e pjesmarrësve nuk kanë asgjësuar barna asnjëherë dhe nuk kanë njohuri me procedurat e asgjësimit.

5. Rreth 80% e pjesmarrësve në pyetsor, deklarojnë se në punën profesionale ju pengon mungesa e barnave në treg.
6. Rreth 60% të pjesmarrësve në pyetsor deklarojnë se ju pengon në punë mungesa e recetës.
7. Rreth 60% e pjesmarrësve i konsiderojnë problematike kriteret e licensimit të barnatores komunitare, të përcaktuar me UA përkatës. në kuadër të kësaj 73% deklarojnë se licensimin e barnatoreve duhet ta bëjë OFK.

Po ashtu edhe gjatë konferencës "Transformimi dhe kujdesi farmaceutik", Komisioni ka pregaditur anketë të re në të cilën do të hulumtohen njohuritë e pjeëmarrësve rreth Udhëzimit Administrativ nr 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili njëkohësisht bën edhe njoftimin e farmacistëve për obligimet të cilat rrjedhin nga ky udhëzim.

## 7. NDËRKOMBETARIZIMI I OFK-SË



drejta të plota në Federatën Internacionale të Farmacisë. Ky pranim do të ndikojë direkt në zhvillimin e farmacisë në vend dhe rritjen e ndikimit të saj në shoqëri.

### 7.1 International Pharmaceutikal Federation (FIP)

Në Kongresin botëror të farmacisë që është mbajtur në Glasgoë, me aklamacion është votuar që edhe Oda e Farmacistëve të Kosovës të pranohet me të



## 7.2 Pharmaceutikal Group of European Union- PGEU

Në qershor të vitit 2019, asambleja e përgjithshme e PGEU-se me shumicë votash ka miratuar aplikimin e OFK-së për pranim në grupin e farmacistëve të Bashkimit Evropian duke hapur një faqe të re për farmacinë kosovare

## 7.3 Asociacioni i Odave të Evropës Juglindore

Janë mbajtur disa takime në Sarajevë, Dubrovnik dhe Neum për nënshkrimin e statutit të asociacionit por që ende nuk është kryer për shkak se kanë mbetur të adresohen paqartësitë e aktit të themelimit, barabarësisë së odave mes vete, llogarisë bankare dhe vulës. Gjithashtu OFK ka bërë kërkesë që pasi fillimisht në themelimin e asociacionit ka pasur statusin e vëzhguesit të aprovet statusi i anëtarit me të drejta të plota. Mbetet të shihet që në takimin e rradhës të finalizohet edhe nënshkrimi i statutit dhe OFK të jetë e barabartë me të gjithë anëtarët tjerë për të cilën gjë gjithashtu do të merret edhe vendimi nga kuvendi i OFK.

## 8. BASHKPUNIMI ME INSTUCIONE TJERA DHE LOBIMET

### 8.1 Inspektoriat farmaceutik



Më 14.09.2018 është nënshkruar memorandumi i bashkpunimit me Inspektoriatin Farmaceutik të përfaqësuar nga Dr. Shaban Osmanaj – drejtor i Inspektoratit Farmaceutik


Me këtë memorandum synohet zhvillimi i bashkëpunimit të ngushtë midis palëve në memorandum, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit ligjore që kanë. Ky



Memorandum ka për qëllim veçanërisht ngritjen e nivelit të veprimtarisë dhe aktiviteteve përkitazi me shëndetin publik në institucionet publike dhe private Farmaceutike në Republikën e Kosovës. OFK dhe IF u dakorduan që të kenë kontakte të vazhdueshme lidhur me zbatimin e Ligjit për Shëndetësinë, Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore me qëllim të bashkërendimit institucional dhe ngritjes së kujdesit shëndetësor ndaj qytetarëve në institucioneve shëndetësore farmaceutike.

## 8.2. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale

Pas shqetësimit të shprehur nga pjesëmarrësit – farmacistët në konferencën e mbajtur më 16 dhe 17 Nëntor 2018 lidhur me vlefshmërinë e licencave kryetari i OFK dhe UD.Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM u takuan për të diskutuar për këto procese dhe sqarimin e tërë kësaj situate të krijuar në mënyrë që edhe udhëzimet administrative të interpretohen saktë dhe zbatimi i tyre të mos krijojë paqartësi të farmacistët lidhur me proceset e akreditimit vjeçar të licencës dhe rilicencimit pas 5 vitesh. Pas këtyre diskutime, AKPPM me 17 Maj ka filluar procesin e rilicencimit në mënyrë sic është e parapare me Udhëzimin Administrativ nr. 11/2015 Qarkulluesit me pakicë për produkte dhe paisje medicinale, sipas të cilit dokumentacioni i nevojshëm për rilicencim është Aplikacioni i rilicencimit, pagesa e tarifës vjetore për rilicencim dhe deklarata se nuk ka ndryshim të kushteve të licencës për barnatore





### 8.3 Fushata "Per barna - fol me farmacistin".

#### Shënohet dita botërore e farmacistit.

Oda e Farmacistëve të Kosovës shënoi ditën botërore të farmacistit me një nga aktivitetet në Ministrinë e Shëndetësisë ku u organizua një takim me Ministrin e Shëndetësisë Z.Uran Ismaili, Sekretarin e Përgjithshëm Z.Naim Bardiqi, Ud.Kryeshefin Ekzekutiv të AKPPM Z.Arian Ahmeti, përfaqësuesit nga OFK me ç’rast u lansua edhe animacioni për fushatën “Për barna – fol me farmacistin”.

OFK por në përgjithësi edhe tërë sektori farmaceutik morrën përkrahje të pazervë nga Ministri i Shëndetësisë i cili theksoi se maksimalisht do të punojë me të gjitha strukturat e sektorit farmaceutik në mënyrë që farmacistët të marrin rolin e tyre jo vetëm në barnatore por edhe në tërë segmentin ku ka përdorim të barnave.

OFK falendëroj Ministrin Ismaili, strukturat tjera udhëheqëse të shëndetësisë dhe uron të gjithë farmacistët për ditën botërore të farmacistëve!



Në kuadër të ditës botërore të farmacistëve, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka organizuar fushatën “Për barna - fol me farmacistin” me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve për rolin e farmacistit. OFK me rastin e shënimit të kësaj dite ka lanësuar edhe animacioni për fushatën.


Gjithashtu u organizua aktivitet simolik i takimit me qytetarë në Sheshin Zahir Pajaziti në Prishtinë ku diskutuam me qytetarët për rolin e farmacistit, aktivitet që u mirëprit nga të gjithë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që të informonim qytetarët që të mos kenë hezitim të pyesin rreth çdo gjëje që ka të bëjë me barnat, dozimin dhe mënyrën e përdorimit, efektet anësore, ndërveprimet e barnave etj.

## Dita Botërore e Farmacistit

25 Shtator 2018

### Cili është roli i farmacistit?



**PËR BARNÄ – FOL ME FARMACISTIN.**





#### 8.4. Komiteti Specialistik

Pas një kohe të gjatë ku specialistantët për disa vite po prisnin për të filluar procesin e specializimit, pas shumë angazhimeve dhe ngritjeve të shqetësimit të kolegëve farmacistë në Ministrinë e Shëndetësisë është emëruar komiteti specialistik për farmaci, me ç’rast mbi 40 farmacistë të cilët me vite kishin pritur fillimin e procesit të shkollimit specialistik filluan aktivitetet e këtij procesi dhe tashmë me rastin e publikimit të këtij raporti veçse kanë përfunduar vitin e parë. Kontributi i OFK dhe Degës së Farmacisë të Fakultetit të Mjekësisë ka qenë shumë domethënës në këtë proces dhe Ministria e Shëndetësisë e ka mirëpritur këtë gatishmëri për të ciën gjë edhe ka ndërrmarë të gjitha masat që kjo të ketë qëndrueshmëri. Gjithashtu MSH ka filluar procesin e revidimit të Udhëzimit Administrativ për shkollim specialistik dhe në grupin punues edhe OFK ka deleguar anëtarin me synimin që pjesa e farmacisë të rregullohet pas disa ndryshimeve në të kaluarën ku është cënuar ky proces.



## 8.5 Konferenca vjetore e farmacisë

Me 16 dhe 17 Nëntor Oda e Farmacistëve të Kosovës në bashkpunim me AKPPM, FSSHK, SHFarmK organizoi konferencën vjetore ndërkombëtare të farmacisë “**Sigurimet shëndetësore dhe roli i farmacistit në këtë proces**”

**Në këtë konferencë ishin të pranishëm 8 ligjërues ndërkombëtarë dhe 17 vendorë.**

**Pjesëmarës pasive në konferencë ishin rreth 920 pjesëmarrës.**



## 8.6 Diskutimi publik me farmacistë dhe institucionet publike

Me 24 Janar 2019, Oda e Farmacistëve të Kosovës ka organizuar debat publik me farmacistet dhe përfaqesues të institucioneve qeveritare (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregëtisë, Fondi për Sigurime Shëndetësore, Agjencia e Kosovës për Paisje dhe Produkte Medicinale dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës) në të cilën janë shqyrtuar tema të rëndësishme për komunitetin farmaceutik si: Unifikimi i cmimit të barnave, Inspektimet në doganë dhe vendosja e flamujve në produkte medicinale.

Pjesëmarrësit u pajtuan që sa më parë të miratohet Udhëzimi Administrativ për unifikimin e çmimeve të barnave. S i përket depove doganore, të kërkohet nga doganat dhe Ministria e Financave që të mundësojnë rikthimin e funksionit të tyre. Kurse, për flamujtë, u vendos që të kërkohet një interpretim i saktë pasi produktet medicinale nuk janë produkte që konsumatori apo pacienti i zgjedh vetë, por që ato dispensohen nga farmacistët (pjesa e recepturës duke përjashtuar produktet parafarmaceutike për të cilat mund të mbetet në fuqi vendimi i vendosjes së flamujve).



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS**  
Komora Farmaceuta Kosova  
Kosova Chamber of Pharmacists



|       |   |
|-------|---|
| Për:  | Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës<br>Komisioni Parlamentar për Shëndetësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës |
| Nga:  | Arianit Jakupi – Kryetar i OFK-së   |
| Tema: | Propozim amandamenti i Ligjit për Pagan në Sektorin Publik  |

Të nderuar,

Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë ka procedur projektligjin për pagat në sektorin publik me të cilin ka përcaktuar sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publik, që paguhen nga buxheti i shtetit dhe rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë.

OFK konsideron se klasifikimi i paraqitur për pozitën e farmacistit në aneks të projektligjit nuk përshkruan me përgjigjesitë, rolin dhe rëndësinë e farmacistit në sistemin shëndetësor, prandaj kërkohet nga ju të keni parasysh propozimet e paraqitura nga anëtarët e OFK-së që kanë të bëjnë me pozitën e farmacistit përkatësisht kategorizimin dhe koeficientin e vendosur për farmacist sipas këtij projektligji. Disa profile nuk gjenden fare të kategorizuar në këtë projektligji, edhe pse i njëjti përmban kategorizimin e tillë për profilet e tjera shëndetësore prandaj vlerësojmë që do të ishte e arsyeshme që të përshkruhet qartë rangimi (megjithëse propozimi fillestar ka bërë vetëm rangimin bazik) dhe koeficientët të jenë të njëjtë për kategori si:

- Teknik i mjekësisë/ Teknik i Stomatologjisë/ Teknik i farmacisë – koef 3.5
- BSc i farmacisë – koef 4
- Doktor i mjekësisë/doktori i stomatologjisë/magjistër ose doktor i farmacisë – koef 4.5
- Doktor i mjekësisë në specializim/ doktori i stomatologjisë në specializim/ magjistër ose doktor i farmacisë në specializim – koef 5
- Doktor i mjekësisë/ doktori i stomatologjisë specialist/ magjistër ose doktor i farmacisë specialist – koef 5.5.

Kategoritë tjera të profesionistëve shëndetësorë në nuk mund të ndërhyjmë dhe besojmë se janë paraparë me rregull por këto i shënuam vetëm si shembuj të kategorizimit.

Mbetemi me shpresë që ky ligj do të ndryshohet gjatë procesit të amandamentit duke parashikuar edhe vlerë të dinjitetshme të koeficientit sipas kategorive dhe në përputhje me shqetësimet tona si profesionistë shëndetësorë.

për: Kryetari i OFK-së  
Dr.sc. Arianit Jakupi



## 8.7 Ligji për paga

Miratimi i Ligjit për Paga, për herë të parë, ka nivelizuar dhe standartizuar pagat për farmacistët në spitale dhe Institucionet tjera Publike Shëndetësore.

Me këtë rast, Oda e Farmacistëve të Kosovës falënderon ministrin e shëndetësisë, Uran Ismaili për përkushtimin e madh në avancimin e këtij ligji, si

dhe, Komisionin Parlamentar për Shëndetësi që kanë trajtuar me korrektësi kërkesat e Odës.

Me ligjin për paga, farmacistët tani e tutje do të trajtohen njësoj sikur mjekët, stomatologët, dhe kjo do të jetë e njëjtë edhe për specialistët dhe specialistët e farmacisë.

Oda e Farmacistëve të Kosovës, është e sigurt se trajtimi i dinjitetshëm që u është bërë farmacistëve përmes këtij ligji, jo vetëm që të ngris cilësinë e shërbimeve të tyre, por do të ndikoj direkt edhe në rritjen e numrit të farmacistëve nëpër klinika dhe reparte.

Aprovimi i Udhëzimit për çmime të barnave, që pritet të bëhet gjatë këtij muaji, është edhe një tjetër sinjal i fuqishëm, për rregullimin e sektorit të farmacisë në Kosovë.

Oda e Farmacistëve të Kosovës do të vazhdojë të japë kontributin e saj profesional në të gjitha zhvillimet për avancimin e pozitës së farmacistit dhe sektorit të shëndetësisë në përgjithësi.

#### 8.8 Projekti lidhur me implementimin e skemës së barnave jashtëspitalore me komponentat përcjellëse të kontraktimit dhe reimbursimit të barnave.

Në zyrat e OFK , u priten nga anëtarët e Këshillit Drejtues në takim gjithëpërfshirës ekspertët Z.Poul Thim dhe Znj.Blerina Tushi nga projekti lidhur me implementimin e skemës së barnave jashtëspitalore me komponentat përcjellëse të kontraktimit dhe reimbursimit të barnave. Në takim u diskutua lidhur me komponentat e ndryshme të procesit dhe sidomos ato më të ndjeshme të



në grupe të caktuara.

kontraktimit dhe inspektimeve.

Dy ekspertës sqaruan se procesi është i dizajnuar në atë mënyrë që do të jetë i hapur për të gjithë farmacistët –barnatoret dhe në asnjë mënyrë selektiv apo i drejtuar



Këshilli Drejtues njoftoi ekspertët lidhur me iniciativën për hartimin e Ligjit për Farmaci i cili mungon në Kosovë, Ligj i cili do të përmblihte të gjitha çështjet e profesionit të farmacistit duke i definuar ato me saktësi dhe duke i ndarë saktë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e farmacistit.

### 8.9 Takimi me Komisionin për Shëndetësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Në vazhden e takimeve të rëndësishme lidhur me trajtimin e problemeve të sektorit farmaceutik, pritëm në takim Komisionin Parlamentar për Shëndetësi të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Deputetët Besa Baftiu, Fatmire Kollçaku dhe Naser Rugova, u njoftuan për progresin që po bëjmë në sektorin farmaceutik. Së bashku diskutuam edhe për zbatimin e Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Anëtarët e Komisionit u zotuan se do të na përkrahin në çështjet

legjislative që sektori farmaceutik të harmonizohet dhe të jetë në hap me direktivat e BE-së për praktikat e mira të farmacisë, për çka u jam shumë falënderues. Oda e Farmacistëve të Kosovës gjatë takimit shprehi gadishmërinë e saj të jetë në dispozicion për të dhënë ekspertizën profesionale edhe në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale ose ligjeve të tjera të cilat

bien në domenin e farmacisë



### 8.10 Bashkpunimi me degën e farmacisë të Universiteti “Hasan Prishtina”

Me 18 Prill, së bashku me nënkryetaren e OFK-së dhe kryetarin e KEVP-se, ne takim me shefen e Departamentit të Farmacisë, Prof. Pranvera Breznica Selmani e cila na bëri një vizitë në OFK, diskutuam gjatë për planet për vitin 2019 si dhe për zhvillim të vazhdueshëm

e për projekte tjera shkencore dhe profesionale për sektorin farmaceutik. Gjithashtu diskutuam edhe për planet e OFK si dhe bashkëpunimin e përfshirjen e personelit akademik në proceset akredituese dhe proceset e licencimit të cilat zhvillohen nga OFK. Në këtë takim znj. Breznica premtoi se dega do të mbështesë OFK-në në këto procese.

### 8.11. Koncepti i dokumentit për ndryshimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale

1 barnatore në 3 mijë banorë dhe distancë mes tyre sipas kriterëve dhe standarteve evropiane.



Kjo ishte një ndër çështjet që si kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës kam ngritur në takim me përfaqësues nga institucionet e ndryshme gjatë diskutimit të konceptit të dokumentit për ndryshimin e Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale.. Si Odë e Farmacistëve të Kosovës, dotë

marrim pjesë rregullisht në të gjitha takimet e radhës deri në aprovimin e ligjit, me qëllim të shtyrjes përpara të politikave të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punën e farmacistit por edhe në proceset e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të produkteve medicinale

### 8.12 Udhëzimi administrativ për shkollim specialistik dhe bordi qendror për shkollim specialistik

Oda e Farmacistëve të Kosovës ka deleguar në grupin punues për hartimin e plotësimit ndryshimeve të udhëzimit administrativ për shkollim specialistik, kryetarin e Komisionit për Edukim Specialistik z. Visar Emini i cili njëkohësisht është i deleguari i OFK-së në Bordin për shkollim specialistik të Ministrisë së Shëndetësisë.



### 8.13. Grupi punues për të drejtat dhe përgjegjësitë e profesionistëve shëndetësorë



Ministria e Shëndetësisë ka themeluar grup punues në të cilin po hartohet një koncept dokument për Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e profesionistëve shëndetësor, i cili do të specifikojë taksativisht të drejtat dhe përgjegjësitë për secilin profil mjekësorë.

Në këtë takim OFK po përfaqësohet nga nënkryetarja Dardane Mehaj.

### 8.14 Udhëzimi administrativ për unifikimin e cmimit të barnave

Udhëzimin Administrativ nr 02/2019 i MSH-së për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale u nënshkrua në më 27 Maj. OFK kishte rol kyç në hartimin e këtij udhëzimi administrativ. Ky udhëzim administrativ e parasheh OFK si pjesë e komisionit për vendosjen e çmimeve të produkteve medicinale. OFK në këtë UA ka rol ky i cili veçmas vihet në pah në procesin e mbikqyrjes së zbatueshmërisë dhe sanksioneve të këtij Udhëzimi Administrativ, ku parashihen 3 mekanizma përmes të cilat do të monitorohet zbatimi i tijë.



### 8.15 Objekti i përbashkët i Odave të Profesionistëve Shëndetësorë

---

Odat e Profesionistëve Shëndetësorë kanë arritur marrëveshje parimore (verbale) për participim në ndërtimin e objektit të përbashkët të OPSH-ve. Objekti i përbashkët do të ndërtohet brenda hapësirave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Tashmë edhe zyrtarisht kemi marrë njoftimin nga LUX = Development për ndarjen buxhetore në vlerë prej 500,000€ për ndërtimin e objektit. Pjesa prej 150,000 € do të sigurohet nga OPSH, dhe 150,000 € nga Ministria e Shëndetësië. Sipas marrëveshjes në parim participimi i OFK-së në këtë projekt do të jetë rreth 17,125 € për 125 metra katrorë, për miratimin e së cilës do të vendos Kuvendi i OFK-së.

### 8.16 Digjitalizimi i shërbimeve

---

Lux-Development ka mbështetur projektin e përbashkët të OPSH-ve për digjitalizimin e shërbimeve të ofruara nga OPSH. Digjitalizimi përfshin modulin për krijimi e regjistrin të anëtarëve, modulin për licencim dhe rilicencim, modulin për regjistrin e procedurave disiplinore, modulin për përcjelljen e aktiviteteve të EVP-së dhe shërbime tjera. Ky projekt është në fazën e përpilimit të specifikacioneve teknike për zhvillimin e sistemit të lartpërmendur, dhe shpresojmë që implementimi i tij në praktikë të fillojë në fillim të vitit 2019.

### 9.1. Takimi me ShSKUK


Takimi me drejtorin e ShSKUK Z.Basri Sejdiu ku u diskutua rreth bashkepunimit reciprok ne mes te Odes se Farmacisteve - OFK dhe SHSKUK. Në kuadër të këtij bashkepunimi u permend fuqizimi i rolit të farmacistëve klinik në kuadër të SHSKUK, rritja e numrit të tyre ku u theksua se do të hapen 5 pozita te reja, me tej nga ana e OFK u theksua përkrahja për edukimin e vazhdueshëm profesional, trajnimet e ndryshme për farmakovigjilencë dhe për menaxhim të barnave si dhe për ofrimin e disa projekteve të cilat kanë të bëjnë me dhomat aseptike për përgatitjen e përgatesave të ndryshme sterile apo përgatitjen e barnave me doze individuale per indikacione te caktuara.



### 9.2 Takimi me delegacionin nga Global Health Policy Research Lab të Dartmouth Nelson A. Rockefeller Center for Public Policy, SHBA.

Takimi i kryetarit të OFK Arianit Jakupi, Prodekanit të Fakultetit të Mjekësisë Kreshnik Hoti dhe delegacionit nga Global Health Policy Research Lab të Dartmouth Nelson A. Rockefeller Center for Public Policy, SHBA.

Gjatë takimit në mes të kryetarit të OFK Arianit Jakupi, Prodekanit të Fakultetit të Mjekësisë Kreshnik Hoti dhe delegacionit nga SHBA u



diskutua për rolin e farmacistëve në sistemin shëndetësor, procesin e dhënies së barnave me recete, çmimet e barnave, posaçërisht për kujdesin paliativ të pacientëve dhe gjithashtu edhe çështja e trajnimit të farmacistëve në lidhje me barnat për menaxhimin e dhimbjes.



### 9.3. Takimi i organizuar nga KDI

Gjatë takimit të organizuar nga KDI ku OFK u përfaqësua nga kryetari Arianit Jakupi dhe nënkryetarja Dardane Mehaj.

OFK falenderon KDI për ftesën dhe për interesimin për të bërë hulumtime për sektorin e shëndetësisë ku u prekën tema të ndjeshme si kontraktimi i produkteve nga lista e barnave esenciale (LBE),

hartimi dhe revidimi i LBE, kriteret për kontraktim (me theks në ruajtjen e kualitetit dhe sigurisë për produkte dhe pajisje medicinale në raport me procedurat e prokurimit), rritjen e transparencës dhe llogaridhënies etj.

Ne si OFK e theksuam rolin tonë si institucion profesional që jemi në dispozicion për të dhënë ekspertizën tonë lidhur me çështjet që janë të ndërlidhura me barnat dhe farmacinë.



### 9.4 Takimi për amandamentimin e Ligjit për Narkotik.

Kryetari i OFK Arianit Jakupi ka marr pjesë në grupin punues për amandamentimin e Ligjit për Narkotik (në cilësinë e vëzhguesit) së bashku me kolegë të tjerë nga OFK, MSH, AKPPM, zyrtarë nga Doganat e Kosoves, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shoqatat profesionale.

Nga OFK në këtë grup Armend Jashari është i deleguar nga mandati i kaluar kurse Liridon Shala është i deleguar nga Shoqata e pacientëve.

Me këtë rast OFK falenderon anëtarët e saj për kontributin e tyre profesional që po e japin në këtë grup punues.



## 9.5. Vizita te prodhuesit vendorë Trepfarm dhe Gentipharm

Në vizitën e parë zyrtare me kompanitë edhe simbolikisht filloi me dy prodhues vendorë në mënyrë që të shprehet vullneti dhe përkrahja maksimale në zhvillimin e këtij segmenti kaq të rëndësishëm të sektorit farmaceutik.

Te të dy këta prodhues bisedat u zhvilluan kryesisht duke u fokusuar në çështjet e prodhimit, teknologjisë farmaceutike, programit të licencimit të farmacistëve dhe praktikës farmaceutike në prodhim, pjesëmarrjes me produktet vendore në përqindja sa më të lartë jo vetëm në vend por edhe shtetet tjera si dhe përkrahjes në promovimin e prodhimit vendor.

OFK shprehet e rezervë se do të jetë në çdo hap përkrahëse e praktikave të mira të prodhimit dhe do të jetë çdoherë e gatshme tu dalë nda ndihmë prodhuesve vendorë



## 9.6 Konferenca e 3 të nderkombetare e shkencave mjeksore e organizuar nga Universiteti I Tetoves .

Oda e Farmacistëve të Kosoves ishte e ftuar zyrtarisht dhe u perfaqesua nga nenkryetarja, zonja Dardane Mehaj dhe kryetari i komisionit per praktiken e mirë profesionale , Liridon Shala . Delegacioni ynë në këtë konferencë patë takime të rëndësishme me:

Rektorin e USHT-se Prof. Dr. Vullnet Ameti



Dekanin e FSHM-se prof. Dr. Kastriot Haxhirexha

Prodekanen e FSHM-se Mr. Sc. Sihana Ahmeti Lika

Kryetarin e Kuvendit të Odes së Farmacistëve të Maqedonisë Mr. ph. Imer Imeri si dhe sekretaren gjenerale të Odes së Farmacistëve të Maqedonisë Mr. ph. Maja Kovaceva

Në të gjitha keto takime u diskutuan qeshtje me interes te perbashket të të dyja vendeve per sektorin farmaceutik

### 9.7 Dita ndërkombëtare e mbulimit universal me shërbime shëndetësore

Nënkryetarja e OFK-së Dardane Mehaj në ka marrë pjesë në takimin e organizuar në ditën ndërkombëtare të mbulimit universal me shërbime shëndetësore 12.12.2018, nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK, në bashkëpunim me Platformën “Kosova që Duam”, të përkrahur nga fondacioni Friedrich-Ebert-Stiftung, kanë mbajtur tryezën e tretë me radhë, me temën: Sigurimet shëndetësore po fillojnë ?!

Qëllimi i tryezës ishte të bëjë një evaluim të gjithë këtij procesi dhe të vë në pah edhe sfidat që mundet t'i ketë procesi i implementimit të Sigurimeve Shëndetësore, të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime nga këto diskutime dhe të njejtat të përcjellen tek akterët kyq në këtë proces.

Në tryezën e organizuar të ftuar ishin përfaqësues të institucioneve relevante, si: Përfaqësues të Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministri i Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, Drejtori i Fondit të



Sigurimeve Shëndetësore, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ekspert dhe njohës të sigurimeve shëndetësore, OJQ , media dhe palë të tjera të interesit.

Të pranishëm në Panel ishin z. Luan Jaha, këshilltar për shëndetësi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; z. Fatmir Plakiqi, Drejtor i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore; Hana Xhemajli, Friedrich-Ebert-Stiftung dhe z. Muhamedali Kodra nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK.



### 9.8 Takimi në Gjenevë në selinë e OBSH dhe në Kopenhagë në zyrat e OBSH - Euro

Me ftesë të OBSH-së, në Gjenevë, kryetari i OFK-së ka marrë pjesë në takimet të cilat janë organizuar lidhur me përzgjedhjen e barnave të Listës Esenciale. Përveç kësaj, është diskutuar edhe për pajisjet mjekësore, pajisjet diagnostike dhe ato ndihmëse.

Si kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës, ka falnderuar zyrën e OBSH-së në Prishtinë dhe Zonjën Ardita Tahirukaj, për angazhimin në përmirësimin e përgjithshëm të situatës në sektorin farmaceutik dhe që na ka mundësuar pjesëmarrjen në këtë nivel të lartë të përfaqësimit.




### 9.9 Takimi me Rrjetin e Konsumit të Antimikrobikëve (Antimicrobial Consumption Netëork) në OBSH Euro në Kopenhagë

Me ftesë nga OBSH Kryetari i OFK-së mori pjesë në Takimin e Rrjetit të Konsumit të Antimikrobikëve (Antimicrobial Consumption Netëork) në OBSH Euro në Kopenhagë. Takime këto që përveç raportimit të të dhënave të konsumit të antibiotikëve në Kosovë, kishin për qëllim edhe krahasimin me shtetet tjera, njohjen me masat të cilat ndërmeren në vende të ndryshme, njohjen me të rejtat e kësaj fushe në botë, ligjërata të ndryshme nga ekspertë me renome nga kjo fushë dhe ëorkshope në të cilën synohet që me punë praktike të përcillen njohuritë edhe në kuadër të grupeve punuese.

Në këtë takim u prezantuan të arriturat e Kosovës në këtë drejtim duke qenë ky viti i shtatë për raportimin, por edhe që së bashku me Prof. Shaipin dinjitetshëm përfaqësuaam Kosovën në seancat e ndryshme të kësaj ngjarjeje.

Dëshmia më e mirë e punës së ekipit në Kosovë është edhe publikimi i disa artikujve shkencor në revista prestigjioze në fushën e antibiotikëve për të cilin OBSH inkurajon edhe shtetet tjera të publikojnë.



### 9.10 Debat i organizuar nga Ministria e Shëndetësisë



Në mars të vitit 2019, nën matronatin e Ministrit të Shëndetësisë u organizua takim publik me palët e interesit në të cilin Oda e Farmacistëve të Kosovës u përfaqësua nga Këshilli Drejtues i saj dhe komisioni për barnatore komunitare. Përfaqësuesit e OFK-së në takim argumentuan mi domsdoshëmërinë e aplikimit të udhëzimit administrativ për unfikimin e çmimit të barnave si kërkersë kryesore të komunitetit farmaceutik. Në këtë debat, përfaqësuesit e OBSH-së e shtruan nevojën e nxjerrjes së një udhëzimi të tillë, pasi që vetëm Kosova dhe Bjellorusia janë vendet e vetëm në Evropë të cilat nuk kanë një mekanizëm për rregullimin e çmimit të barnave.



### 9.11 Në takimin me AKPPM dhe Inspektorati për Udhëzimin e ri Administrativ për kushtet e licencimit të Depove të barnave.

Gjatë takimit të përbashkët në të cilin falenderuam kolegët nga komisioni për punën e palodhshme dhe posaçërisht kryeshefin Arian Ahmeti për një takim në të cilin në rend të parë ishte profesionalizmi duke pasur synim sigurinë e produkteve medicinale por edhe eliminimin e burokracisë me rastin e procedurave administrative në AKPPM.

Me këtë rast po krijohet një bazë e shkëlqyeshme në të cilën kushtet e licencimit po definohen saktë në mënyrë që tu iket problemeve të cilat kanë qenë si shkak i mosdefinimit të qartë. Në këtë e përfaqësuam OFK-në bashkë me anëtarin e Këshillit Drejtues Astrit Iljazi.



### 9.12 Në takimin e organizuar nga American Chamber of Commerce in Kosovo – grupi i shëndetësisë, për të diskutuar për aktualitetet dhe sfidat në proceset e funksionalizimit të sigurimit shëndetësor në Kosovë.



### 9.13. Kongresi i 6-të i farmacisë në Dubrovnik

Si kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës, mora pjesë në kongresin e 6 -të të farmacisë në



Dubrovnik që u mbajt prej 4-7 Prill. Në këtë kongres, në të cilin përfaqësuam Kosovën me ftesë të Odës së Farmacistëve të Kroacisë, diskutuam shumë çështje lidhur me orientimin e politikave për të ardhmen e farmacisë.

Temë e pashmangshme ishte edhe rruga si do të bëhet formësimi i profesionit tonë në epokën e digjitalizimit dhe ndryshimeve të mëdha në sektorin e shëndetësisë në botë dhe në rajon. Pjesë e rëndësishme e këtyre

diskutimeve ishte fokusi i ndryshimit të rolit të farmacistit nga orientimi në produkte, në orientimin në shërbime profesionale të farmacisë. Specializimet e ndryshme të cilat mund tu ofrohen farmacistëve në mënyrë që ata të krijojnë kompetenca të shtuara për punën e tyre profesionale ishte edhe një tjetër temë me interes që u shtjellua aty.

### 9.14. Takimi për listën e barnave esenciale me komitetin profesional



### 9.15. Dita Botërore e Shëndetit

Me ftesë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë - zyra në Prishtinë në shënimin e “Ditës Botërore të Shëndetit” për të prezantuar të arriturat në reformën e farmacisë si dhe ndihmën e rezervë të OBSH në këtë procese ishte pranishëm kryetari i OFK-së, me ç’rast falënderojë Dr.Ardita Tahirukaj - shefe e zyrës së OBSH ne Kosovë, për punën e palodhshme dhe përkrahjen për sektorin e farmacisë në projekte të ndryshme qëllimi i të cilave është ngritja e cilësisë së shërbimeve profesionale në sektorin farmaceutik.



### 9.16 Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë

Në dhjetor 2018 ,një delagacion nga Oda e Farmacisteve të Kosovës (Gjon Gega, Shkumbin Jusufi, Sabrije Fazliu dhe Agon Hoti) ishte pjesëmarrës në ceromoninë e mandatimit të këshillit të katërt kombëtar të Urdhrit të Farmacisteve të Shqipërisë.

### 9.17. Takimi me Minsitrin e Shëndetësisë dhe zyrtarët nga Autoriteti i konkurrencës

Sektori farmaceutik është para reformave më të mëdha në historinë e shtetit të Kosovës. Natyrisht, e gjithë kjo falë punës shumë të madhe që ka nisur Ministri i Shëndetësisë Uran Ismaili për ta rregulluar këtë sektor. Udhëzimi për rregullimin dhe unifikimin e çmimit të barnave është vetëm një prej tyre ku përfitimet për shtetin dhe qytetarët do të jenë të shumta e farmacistit do t'ia kthejnë dinjitetin. Si OFK do të jemi përkrah këtyre zhvillimeve duke dhënë ekspertizën përmes komisioneve tona profesionale.





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS**  
 Komora Farmaceuta Kosova  
 Kosova Chamber of Pharmacists



**RAPORTI VJETOR 2018**

**RAPORTI I PERGJITHSHEM FINANCIAR 2018**

| <b>TE HYRAT</b>   | <b>Realizimi ne €</b> |
|---|-----------------------|
| Të hyrat nga MSH të përcaktuara me Statut dhe Ligj  |                       |
| Të hyrat nga MSH-ja te arketuara pas 3 vjeqarit të themelimit të Odës   |                       |
| Anëtarësimi   | 43,700.00             |
| Licencimi dhe Rilicencimi   | 23,380.00             |
| Certifikatat mbi të kaluarën etike profesionale   | 17.00                 |
| Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanit farmaceutike | 65,001.00             |
| Të hyrat nga marketingu në web faqe   |                       |
| Te ardhurat nga Donatorët   |                       |
| Te ardhurat nga Institucionet   |                       |
| Te hyra te panjohura  | 510.00                |
| <b>TE HYRAT NE TOTAL</b>  | <b>132,608.00</b>     |



| <b>SHPENZIMET (Pagat bruto dhe KPP)</b>   | <b>Realizimi</b> |
|---|------------------|
| Pagat bruto, shpenzimet per meditje per kuvend dhe keshilla dhe komisione (tatimi mbi page eshte i perfshire) | 80,983.09        |
| Kontributet Pensionale të Punëdhënësit  | 3,141.60         |
| <b>TOTALI I SHPENZIMEVE PER PAGA MEDITJE PER KUVEND , KESHILLA DHE KOMISIONE</b>                              | <b>84,124.69</b> |
| <b>SHPENZIMET TJERA OPERACIONALE</b>  |                  |
| Material shpenzues  | 7,000.45         |
| Shpenzimet e telefonit  | 1,240.82         |
| Shpenzimet e derivateve   | 700.00           |
| Shpenzimet e antaresimeve ( FIP , PGEU, ISSN )  | 2,518.00         |
| Shpenzimet per organizimin e konferences dhe kampanjave   | 53,438.65        |
| Provizioni bankarë  | 715.85           |
| Mbështetja e farmacisteve për EVP   | 600.00           |
| Shpenzimet per WEB  | 2,398.20         |
| Mbështetje Financiare nga Fondi për Solidaritet   | -                |
| Shpenzimet per akomodim dhe udhetime zyrtare  | 4,485.71         |
| Shpenzime tjera operacionle   | -                |

|  |                   |
|--|-------------------|
| <b>TOTALI I SHPENZIMEVE OPERACIONALE</b> | <b>73,098.18</b>  |
| <b>PERMBLEDHJA</b>                       |                   |
| <b>SALDO ME 31.12.2017</b>               | <b>85,081.35</b>  |
| <b>GJITHESEJT TE HYRAT</b>               | <b>132,608.00</b> |
| <b>GJITHESEJT</b>                        | <b>217,689.35</b> |
| <b>GJITHESEJT SHPENZIMET</b>             | <b>157,222.87</b> |
| <b>SALDO ME 31.12.2018</b>               | <b>60,466.48</b>  |